

**STATUSI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**"TRIANGOLO SECURITY " SH.P.K**

**KREU I  
Emertimi,Forma,Selia ,Kohezgjatja,Objekti**

**NENI 1  
EMERTIMI**

Sot me date 11.03.2021 une, themeluesi Arben Hysa ,shtetas shqiptar,lindur me 14.03.1963,dhe banues ne Lagja nr 4 rruga Kiri Shkoder,kam krijuar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emrin "Triangolo Security "sh.p.k.

**NENI 2  
FORMA JURIDIKE**

Shoqeria "Triangolo Security "sh.p.k, eshte person juridik i te drejtes shqiptare,shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria")

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete rregjistruar ne Qendren Kombetara te Rregjistrimit ,ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria pasi te kete fituar personalitetin juridik,eshte pergjegjese ndaj te treteve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimitare se saj.

Shoqeria "Triangolo Security "sh.p.k,eshte e tille,kapitali i se ciles ka kuota te plota te cilat themelohen nga ortaku i vetem,qe perballon humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kuntributit te tij te kapitalit themelor.

**NENI 3  
SELIA**

Shoqeria e ka seline ne Shkoder me adresë: **Rruga Qemal Draçini , ndertesa numer 1/526 zona akadastrale 8593 Ndertese 4 kateshe kati I dyte, Shkoder.**

Ajo mund te ndryshoje seline e saj ,mund te hape zyra perfaqesie,dege,te krijoje filial ne te gjithe teritorin e Republikës se Siperise ,vetem me vendim te asamblese se ortakeve.

**NENI 4  
KOHEZGJATJA**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje kohe te pakufizuar,duke filluar nga data e rregjistrimit ne Q.K.B.

**NENI 5  
OBJEKTI**

Ruajtja dhe siguria fizike e objekteve publike e private,e personave fizike vendas dhe te huaj  
Ruajtja e objekteve dhe institucioneve publike dhe private,sigurimin fizik,mbrojtjen e jetes dhe shendetit te shtetasve shqiptare dhe te huaj,instalimin dhe perdorimin e sinjalistikes te radioalarmit dhe paisjeve te tjera te vezhgimit,prodhimin,mirembajtjen dhe tregetimin e paisjeve per shuarjen e zjarreve dhe

shpetimin.Proyektimin dhe instalimin e kontrollit te aksesit dhe sigurise se larte,integrimin e sistemeve.Proyektim,furnizim dhe instalim dhe mirembajtje te sistemeve per prodhimin e energjise alternative(Fotovoltaik Wind) etj.

Furnizimi,instalimi I kasafortave cavoux,sigurinee kutive te depozitave,terminale POS,ATM dhe paisjeve bankare ne pergjithesi.Konsulence dhe analize per sigurine Projektim,furnizim,instalim dhe mirembajtje te sistemeve te intelegrjences.Proyektim,zbatim ,monitorim dhe mirembajtje te sistemeve te shuarjes se zjarrit.Proyektimdhi instalim I paisjeve dhe impianteve elektrike e civile.Furnizim,instalim e mirembajtje I paisjeve te telekomunikacionit dhe radionderlidhjes,import-eksport me shumice dhe pakicei I materialeve te teknologjise elektrike dhe elektronike,paisjeve per navigacion ,import-eksport dhe shitje ndertim dhe mirembajte te avioneve dhe paisjeve te tyre.

Qender e trajnimit,privat te punonjesve te SH.P.S.F dhe atyre qe me ligj u njihet e drejta trajnimit te strukturave ligjzbatusse.Sherbime te ruajtjes ,trasportit dhe shoqerimit te vlerave monetare dhe sendeve te cmuara.Tregetimi I armeve te gjahut dhe paisjeve e materialeve te gjuetise,import\_eksport,,kryerja e transferimrve nderkombetare perfshire dhe sherbimet ndermjetesuese te mallrave ushtarake dhe mallrave te teknologjise , me perdomim te dyfishte, import-eksport-trasport—tregetim-riparim te armeve dhe munitioneve luftarake te percaktuara me ligj,trajnime e certifikeme te personave qe me u lejohet te mbajne arme,certifikime ne fushen e gjuetise dhe sigurise,konsulence per vete dhe te trete ne fushen e sigurise dhe per sherbimin privat te sigurise fizike,polygon stervitje me armet e zjarrit miratuar e certifikuar sipas ligjeve ne fuqi,qender formimi profesional.

#### **KREU II KAPITALI**

#### **NENI 6 KAPITALI THEMELOR**

Kapitali I shoqerise eshte ne vleren 4 000 000 (katermilion) lek.Ortaku themelues I shoqerise tregetare " Triangolo Security"sh.p.k zoteron 1 kuote e barabarte me 100% te kapitalit ne kete shoperi.

Kapitali themelor eshte shlyer plotesisht ne para nga ortaku me themelimin e shoqerise.

Pergjegjesite e ortakut te vetem shtrihen deri ne Shumen e kontributeve te tij ne kapitullin themelor.

#### **NENI 7 ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT**

Kapitali I shoqerise mund te zmadhohet neprajet nenshkrimive te pjeseve te kapitalit themelor per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre,neprajet emerimit nga gjykata kopetente ne eksperi te autorizuar per keto contribute sipas kerkeses se administratorit.

Zvogelimi I kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve,e cila mmerr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi I prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne. Projekti I zvogelimit te kapitalit u komunikohet eksperteve kontabel te autorizuar,ne rast se ka te tille,te pakten 45 dite perpara dates se mbledhjes se asanblese te thirrur per te marre vendim rreth ketij projekti.

Zvogelimi I kapitalit themelor me nje vlere me te vogel se ajo e percaktuar ne nenin 6 te ketij statuti,ben te detyrueshme marrjen e nje vendimi prej shoqerise per zmadhimin e kapitalit themelor te pakten deri ne vleren minimale.

Ne te kundert shoqeria duhet te shnderrohet ne nje forme tjeter.

Ne rast mosbatimi te kerkesave te ketij paragrafi,cdo person I interesuar mund te kerkoje ne rruge gjyqesore prishjen e shoqerise.

Kjo prishje mund te shpallet,ne qoftese rregullimi eshte bere ne diten kur gjykata mblidhet per te marre vendimin.

#### **Neni 8** **Trasferimi I kapitalit**

Pjeset e kapitalit themelor mund tu trasferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri,vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqesojne te pakten tre te katertat e pjeseve te kapitalit themelor.Projekti I trasferimit I njoftohet shoqerise dhe secilit prej ortakeve.Ne rast se shoqeria nuk ka beret e ditur vendimin e saj Brenda tre muajve nga data e njoftimit te fundit sipas paragrafit te mesiperm,miratimi I trasferimit quhet I dhene.

Ne rast se shoqeria refuzon te jape miratimin e trasferimit,ortaket brenda tre muajve nga data e ketij refuzimi ,duhet te blejne apo te lejojne blerjen e pjeseve te kapitalit themelorme vleren e percaktuar sipas rregullave te nenit 11 te ketij statute.Kalimi I kuotave me kontrate shitblerje behet me shkrim dhe noterizohet nga noteri publik.

Pjeset e kapitalit themelor jane lirisht te transferueshme nepermjet ortakeve.

Pjeset e kapitalit themeltar Jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.Ato jane te transferueshme edhe ne raste ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve.si dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

#### **KREU III** **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 9** **Organji Vendimmarrar**

Asambleja e Ortakeve eshte organ I vetem vendimmarres e shoqerise.Ky organ miraton cdo ndryshim te statutit te shoqerise sipas modaliteteteve te percaktuara me ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a)Percaktimi I politikave tregetare te shoqerise.
- b)Ndryshimet e statutit.
- c)Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
- d)Emerimin dhe shkarkimin e eksperteve kontabel te miratuar.
- e)Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "d" te ketij nen.
- dh)Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret,perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise.
- g)Miratimin e pasqyrave financiare vjetore.
- gj)Zmadhimin dhe zvogelin e kapitalit.
- f)Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- h)Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- i)Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- j)Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese .
- k)Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statute.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme ,ne baze te autorizimit,nga nje ortak tjeter ose nga nje person I trete.

Administratori I shoqerise nuk mund te veproje si perfaquesues I ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese,e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

#### **Neni 10**

##### **Menyra e thirrjes se Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet njoftimi me shkrese ose,nese parashikohet nga statute,me njoftim neprerjet postes elektronike.Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbane vendin,daten,oren e mbledhjes dhe rendin e dites e tu dergohet te gjithe ortakeve,jo me vone Asambleja e pergjithshme se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja nuk eshte thirrur sipas ketj nenit,ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjitheortaket jane dakort per te marre vendime pvareshishte parregullesise.

#### **Neni 11**

##### **Kourumi**

A)Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote,qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

B)Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje,te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare",ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem ne perputhje me nenin 12 te ketij statute,kur ortaket Jane te pranishempersonalist,votojne me shkrese,apo me mjete elektronike,sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mlidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur me larte,asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite ,me te njejtin rend dite.

#### **Neni 12**

##### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e pergjithshme vendos me tre te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit,te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statutit,zmadhimin ose zvogelinin e kapitalit te rregistruar,shperndarjen e fitimeve,riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votive te ortakeve pjesmarres,per ceshtje te tjera si:

- 1.Percaktimi i politikave tregetare te shoqerise
- 2.Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
- 3.Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- 4.Percaktimin e shperblimeve.

5.Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret,perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.

6.Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedura te tjera administrative.

7.Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjes se asamblese.

Cdo ndryshim statute duhet te depozitohet prane Q.K.B per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

#### **Neni 13**

##### **Administrimi**

Shoqeria administrohet nga Administratori I cili zgjidhet per nje mandat pese vjecar me te drejte rizgjedhje.

Administratori I shoqerise do te jete Z. Arben Hysa ,shtetas shqiptar,I datelindjes, lindur ne Shkoder dhe banues ne Lagja nr 4 rruga Kiri Shkoder, person memadhor me zotesi te plete per te vepruar,me karte identiteti Nr G30314194F.

Drejtues teknik do te jete Z. Arben Hysa ,shtetas shqiptar,lindur me 14.03.1963 ,ne Shkoder dhe banues ne Lagja nr 4 rruga Kiri Shkoder,me karte identiteti Nr G30314194F ,certifikuar nga drejtoria e

pergjithshme e policies se shtetit Nr. 397/6 ,date 18.07.2019, ne fushen e sigurise fizike,nenkategoria 1.3.A,I cili eshte person madhor ,me zotesi te plote per te vepruar.

Shoqeria perfaqesohet para cdo organi administrative,gjyqesor,ent public apo privat dhe ne marrdhenje me te tretet nga administrator,I cili ushtron keto te drejta ne perputhje me statutin e shoqerise dhe legjislacionin ne fuqi.

Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratoret ne cdo kohe me shumice te zakonshme.Statuti,apo marrveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.Pavec kesaj,administratoret shkarkohen nga gjykata per shkelje te ligjit me kerkesa te cdonjerit prej ortakeve.Tagrat e perfaqesimit te administratorevedhe cdo ndryshim I tyre njoftohen per rregjistrim ne Q.K.B.

Emerimi I administratoreve prodhon efekte pas rregjistrimit ne Q.K.B.

Administrator I shoqerise mund te caktohet edhe nje person jashte ortakerise.

#### Neni 14

##### Kompetencat

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen te:

1.Keyejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqerise,duke zbatuar politikat tregetare te vendosura nga asambleja e pergjithshme.

2.Perfaqesojne shoqerone tregetare.

3.Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise.

4.Pergatisin dhe nenshkruarje bilancin vjetor ,bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe,se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve ,I paradesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim.

5.Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rr Ethanat ,qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.

6.Kryejne rregjistimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise ,sic parashikohet ne ligjin per Q.K.R.

7.Raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregetare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregetare:

Administratoret jane te detyruar te therrasin asamblene e pergjithshme edhe ne rastet kur:

a.Asambleja e pergjithshme therret pasi,sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare,rezulton ose ekziston rreziku qe aktivitetet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme Brenda tre muajve ne vazhdim.

b.Kur shoqeria,Brenda dy viteve te para pas rregjistrimit te saj,propozon te bleje nga nje ortak pasuri,qe kane vlere me te larte se 5%te aseteve te shoqerise,qe rezulton ne pasqyrat e fundit finanziar te certifikuara.

Administratoret kane te drejte te kryejne te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem.Administratoret perfaqesojne shoqerine perpara te gjithe personave fizik e juridik,publik ose privat vendas ose te huaj,perfshi ketu edhe autoritetet gjyqesore te te gjitha shkalleva.Administratoret kane te gjitha kopetencat per te vepruar ne marrdhenje me te tretet ne emer te shoqerise,ne te gjitha rr Ethanat me perjashtim te kopetencave qe ligji ja jep shprehimisht ortakut te shoqerise.Administratoret angazhojne shoqerine ne marrdhenjet me te trtet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Shoqeria nuk merr persiper pasojet ndaj te treteve ,kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti I administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rr Ethanat e dhena,duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Drejtuesi teknik eshte menaxheri me I larte teknik per ,organizimin,drejtimin dhe kontrollin e ketij sherbimi.

**Neni 15**  
**Pergjegjesite**

Administratori eshte pergjegjes individualisht,ndaj shoqerise ose ndaj te treteve,per shkelje te ligjeve,per shkelje te statutit,apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja e pergjithshme qe I sjellin dem shoqerise,I ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marrveshjen,per te perballuar ne menyre individuale ose solidarishte sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14,15,17,18 te ligjit "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare",administrator detyrohet :

1. a.) Te kryej detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi,duke I kushtuar vemandje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjesid.

b.)Te ushtroje kompetencat qe I njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita.

c.)Te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet,per te cilat merret vendim.

d.) Te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit,present apo te mundshem,te interesave personale me ato te shoqerise.

e.)Te ushtroje-detyrat e tij-me profesionalizemin dhe kujdesin e nevojshe.

2. Administratori,gjate kryerjes se detyrave te tij,pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim,qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregetare ,me perjashtim te rasteve kur,ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese,veprimi ose mosveprimi shte kryer ne mirebesim.

3. Nese administrator vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale,sipas pikave 1,2 te ketij neni eshte I detyruar ti demshperbleje shoqerise demet,qe rrjedhin nga kruerje e shkeljes,si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta.Administratora ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standarteve te kerkuara.Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator,ata pergjigjen perballe shoqerise ne menyre solidare.

4. Ne menyre te vecante,por pa u kufizuar ne to,administrator eshte I detyruar ti demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara ,nese ne kundershtim medispozitat e ligjit , "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare",kryen keto veprime:

1.U kthen ortakeve kontributet.

2.U paguan ortakeve interesa apo dividente.

3.U siperndan aktivet shoqerise.

4.Lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregetare,kur,ne baze te gjendjes financiare,duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shluer detyrimet.

5.Jep kredi

Pervec padise pershluerjen e demit qe I ngarkohet personalishte administratorit ,ortaku personalisht ose se bashku,kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plaote te demit qe I eshte shkaktuar shoqerise,perfshire edhe demshperblimin financier,nese eshte e nevojshme.

Asnje vendim I asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

**Neni 16**  
**Viti finanziar**

Viti finanziar I shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.Perjashtimisht,viti I pare finanziar fillon nga data e rregjistrimit te shoqerise ne Q.K.B dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

### **Neni 17**

#### **Bilanci I shoqerise dhe dividenti**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar ,Mledhja e Ortakeve,miraton bilancin e paraqitur nga administratoret.

Mbledhja e ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividentit,pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem finanziar,sic edhe parashikohet ne ligj.

### **Neni 18**

#### **Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko-tregetare te shoqerise,ate gjithvjetor dhe ate nre lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakut.

Ne perfundim te kontrollit ekserti kontabel i autorizuar perqatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit finanziar vjetorsi dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara,te cilat eshte i detyruar qe tja paraqese e dorezoje ne kohe ortakut per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

### **Neni 19**

#### **Dividenti**

Te ardhurat neto (Dividenti)qe mbeten pas vecimit te fondevi ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiscal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve ,I mbeten dhe i kalojne ne pronesi ortakut.

### **Neni 20**

#### **Shperndarja ose prishje e shoqerise**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- 1.Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj.
- 2.Me vendim te asamblese se ortakeve.
- 3.Me hapjen e procedurave te falimentimit.
- 4.Nese nuk ka kryer veprimtari tregetare per nje vit dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3,te nenit 43 te ligjit 9723 date 03.05.2007"Per Q.K.B."

#### **5 ME VENDIM GJYKATE.**

Ne kete rast ortaku merr vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise ,duke caktuar nje opo disa likuiditore dhe shenuar ne cdo document te nxjerre prej tij emrin e likuiditorit dhe emertesen shtese"Shoqeri ne likuidim e siper".

Prishja e shoqerive tregetare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese,me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga ortaku.

Nese ortaku nuk merr nje vendim per emerimin e likuiduesve,Brenda 30 diteve pas prishjes,cdo person i interesuar mund te drejtohet gjykates,per te caktuar likuidues.

### **Neni 21**

#### **Likuiduesi**

Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij.

Nese shoqeria emeron me shume se nje likuidues,perverse kur akti i emerimit parashikon se ata veprojne vecmas nga njeri tjetri ,ushtrojne bashkarishte te drejtat e detyrimet sipas ketij ligji.Likuiduesit mund te autorizojne njerin prej tyre te kryejne veprime te n je kategorie te posacme.

Kufizimet e tagrave te likuiduesve u kundrejtohen te treteve,ne perputhje me percaktimet e ligjit.

Likuiduesit u nensstrohen mbikqyrjes se ortakut dhe administratorit.

### Neni22

#### Te drejtat dhe detyrimet e likuiduesit

- 1.Detyra e likuiduesve eshte mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise,mbledhja e kredive te paarketuara dhe kontributeve te pashlyera,shitja e pasurive te shoqerise dhe shlyerje e kreditoreve duke respektuar radhen e referimit,sipas nenit 605 te Kodit Civil.
- 2.Likuiduesi mund te kryeje edhe vetrime te reja tregetare, per mbyjen e nje veprimi te papae funduar.
- 3.Nese,ne baze te padive te ngritura nga kreditoret,sipas nenit 194 te ligjit "Per tregetaret dhe shoqerite tergetare",likuiduesit verejne se pasuria e shoqerise tregetare ,perfshire kontributet e pashlyera,nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e ketyre pretendimeve,likuiduesit detyrohen ta pezullojne procedure e likuidimit e ti kerkojne gjykates perkatese nisjen e procedurave te falimentimit.  
Likuiduesi I pergaati nje bilanc te gjendjes se shoqerise ne castin e hapjes se likuidimit dhe nje bilanc perfundimtar ne casti e mbylljes se ketyre procedurave.Nese procedura e likuidimit zgjat me shume se nje vit ,likuiduesi pergaatit,gjithashtu,pasqyrat financiare vjetore te shoqerise.Bilancet ne shoqerine kolektive miratohen nga ortaket e tjere,ndersa ne shoqerite aksionere apo ne ato me perjegjesi te kufizuar miratohen nga asamleja e pergithshme.

### Neni 23

#### Perfundimi I likuidimit

Pas shperndarjes te aktiveve te mbetur,likuiduesi njofton Q.K.B perfundimin e likuidimit dhe kerkon cregjistrimin e shoqerise,ne perputhje me seksionin e V te ligjit nr.9723 date 03.05.2007"Per Q.K.B"

### Neni 24

#### Bashkimi

Dy ose me shume shoqeri mund te bashkohen:

- 1.Kalimi tte te gjitha aktiveve e paisjeve te njeres ose me shume prej shoqerive,qe quhen shoqeri te perthitura,ten je shoqeri tjeter ekzistuese,e quajtur shoqeria perthithese,ne kembim te aksioneve apo kuotave te kesaj shoqerie.Ky proces quhet bashkim me perputhje.
- 2.Themelimit ten je shoqerie te re,tek e cila kalohen te gjitha aktivet e pasivet e shoqerive ekzistuese,qe bashkohen ne kembim te aksioneve apo kuotave te shoqerise se re.Ky proces quhet bashkim me krijim ten je shoqerie te re.

### Neni 25

#### Ndarja

- 1.Nje shoqeri mund te ndahet me vendim te asamblese se ortakeve,duke trsferuar te gjitha aktivet e pasivet e veta ne favor te dy ose me shume shoqerive,ekzistuese apo te themeluara rishtazi.Shoqeria qe ndahet,vleresohet e prishur.
- 2.Per ndarjen e shoqerise zbatohen perkatesishte dispozitat e neneve 216...25 te ligjit 9901 date 14.04.2018.
- 3.Shoqerite,qe fitojne pasurite e shoqerise qe ndahet,quhet shoqeri pritese dhe perjigjen ne menyre solidare per detyrimet e kesaj te fundit.
- 4.Regjistrimi I ndarjes se shoqerise prane Q.K.B ka si pasoje:
  - a) Kalimin te shoqerite pritese te te gjitha aktiveve e pasiveve te shoqerise qe ndahet,ne perputhje me raportin e ndarjes,te percaktuar ne marrveshje e ndarjes.Ky kalim sjell pasoja per marrdhenjet ndermjet shoqerive,si dhe per palet e treat.
  - b) Blerjen e aksionereve/ortakeve te shoqerise qe ndahet,aksionere apo ortake te nje ose me shume shoqerive pritese,ne perputhje me raportin e ndarjes,percaktuar ne marrveshjen e ndarjes.
  - c)Vleresimin e shoqerise qe ndahet si e prishur dhe cregjistrimin e saj nga Q.K.B,sipas seksionit V te ligjit nr.9723 date 03.05.2007 "Per Q.K.B" pa kruerjen e likudimit.

### Neni 26

#### Shnderrimi

Shoqeria mund ta ndryshoje formen e vet ligjore,nepermjet shnderrimit te saj ne shoqeri aksionere.

Shnderrimi nuk sjell pasoja mbi te drejtat dhe detyrimet ,qe shoqeria ka marre persiper ndaj te treteve.

**Neni 27**  
**Baza ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut ,do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregetaret dhe shoqerite trgetare", Kodi Civil dhe cfardo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 28**  
**Mosmarrveshjet**

Per mosmarrveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statute ,si dhe per cdo mosmarrveshje qe mund te linde midis shoqerise dhe te treteve,do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

**Neni 29**  
**Dispozita perfundimtare**

Ky statut eshte document i vetem per themelimin e shoqerise dhe zevendeson cdo akt te meparshem. Ku statut u redaktua ne kater ekzemplare me permbajte dhe vlera te njejtave juridike,ne gjuhen shqipe ,miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregetare Triangolo Security sh.p.k dhe nenshkruhet ne te gjitha kopjet.

**ORTAKU I VETEM**

**Arben Hysa**

